

## Vendim nr. 300 datë 16.12.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 16.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (Dh) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **DHIONISIOS ALFRED BELERI**, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me akt përfaqësimi.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 467, datë 11.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr. 22, datë 29.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr. 00-2024-769, datë 25.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Shfuqizimi i aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Konstatimi i shkeljes së të drejtave kushtetuese të kërkuarit Dhionisios Alfred Beleri.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 1, pika 3, 2, pika 2, 3, 4, 5, 6, pika 1, 7, 15, 17, 18, 42, 44, 45, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1, 13, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 3 i Protokollit shtesë të saj; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe**

**funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri (*kërkuesi*) ka qenë kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

2. Dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve, në datën 12.05.2023, kërkuesi dhe një person tjetër janë arrestuar në flagrancë si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Me vendimin nr. 205, datë 13.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ndër të tjera, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka deklaruar moskompetencën e saj, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore.

3. Në datën 14.05.2023 janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe me vendimin nr. 194, datë 16.05.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88 ka shpallur kërkuesin fitues. Në vijim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*KQZ*), me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023, ka vendosur dhënien kërkuesit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë.

4. Ndërkohë, për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme masa shtrënguese e sigurimit personal e vendosur ndaj kërkuesit nga gjykata jokompetente e rrethit dhe për të cilën është kërkuar vazhdimi i zbatimit, i është nënshtruar shqyrtimit tashmë nga gjykata kompetente sipas përcaktimit të nenit 88 të *KPP*-së. Me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023, *GJKKO-ja e Shkallës së Parë* ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Mbi

bazën e ankimit të kërkuarit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023, ka vendosur të miratojë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Vendimi i GJKKO-së së Apelit është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023. Procesi gjyqësor është kundërshtuar nga kërkuari edhe në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 19, datë 21.03.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

5. Kërkuari ka paraqitur edhe një kërkesë pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe disa të tjera pranë Institucionit për Ekzekutimin e Vendimeve Penale (*IEVP*) për marrjen e lejes së veçantë për t'u paraqitur dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak Himarë. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 266, datë 26.06.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk është autoriteti kompetent për dhënien e lejes së kërkuar nga kërkuari, pasi ajo jepet nga drejtori i institucionit, që në rastin konkret rezultoi të jetë IEVP-ja, me pëlqimin paraprak të prokurorit. Ndërsa, mbi kërkesën e fundit të kërkuarit, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023 (*shkresa nr. 1938/2023*), ka vendosur refuzimin e saj, me arsyetimin se një kërkesë e tillë nuk parashikohet nga ligji nr. 81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (*ligj 81/2020*). Kjo shkresë (nr. 1938/2023) është kundërshtuar nga kërkuari në rrugë gjyqësore.

6. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 371, datë 18.09.2023, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore. Kjo e fundit, me vendimin nr. 137, datë 10.10.2023, ka parashtruar përpara Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes së kërkuarit, me objekt kundërshtimin e shkresës nr. 1938/2023.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1810, datë 07.11.2023, ka vendosur zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe gjykatës së rrethit Durrës, duke përcaktuar si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes, GJKKO-në e Shkallës së Parë. Pa përfunduar ende gjykimi i çështjes nga kjo e fundit, kërkuari, në datën 03.01.2024, nëpërmjet përfaqësueses së tij të zgjedhur me prokurë, i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e shkresës nr. 1938/2023, si të papajtueshme me Kushtetutën. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 57, datë 03.04.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes

për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

8. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë që përcaktonte kompetencën lëndore, çështja është reregjistruar në GJKKO-në e Shkallës së Parë dhe i ka kaluar gjyqtarës së seancës paraprake e cila ka shpallur moskompetencën lëndore dhe çështja i ka kaluar trupit gjykues me tre gjyqtarë që kishte në shqyrtim çështjen penale në ngarkim të kërkuesit.

9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë (trupi gjykues me tre gjyqtarë), me vendimin nr. 467, datë 11.12.2023, ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkuesit me objekt kundërshtimin e shkresës nr. 1938/2023 me arsyetimin se për masën e sigurimit personal “Arresti në burg” legjislativi procedural penal dhe ligji i posaçëm për të drejtat e personave të cilëve u është kufizuar liria nuk parashikojnë mundësinë që personi të lejohet për kryerjen e betimit apo marrjes së detyrës publike. Po kështu, kjo gjykatë ka arsyetuar se praktika gjyqësore e paraqitur nga kërkuesi për të mbështetur pretendimin e tij nuk është e ngjashme me situatën konkrete, pasi rrethanat faktike dhe procedurale të rasteve të paraqitura janë të ndryshme nga ato të kërkuesit.

10. Për ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit (gjyqtari i vetëm), me vendimin nr. 22 (87-2024-30), datë 29.01.2024, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë me arsyetimin se kërkuesi ka marrë cilësinë e të pandehurit dhe për të është konfirmuar masa e sigurisë “Arresti në burg”, e cila i kufizon atij një numër të drejtash dhe lirish, përfshirë edhe të drejtën e pretenduar për dhënien e lejes për t'u betuar me qëllim marrjen e mandatit si kryetar i Bashkisë Himarë. Sipas kësaj gjykate, kufizimi i të drejtave është mbështetur në ligj, i cili nuk parashikon mundësinë që personi i pandehur dhe i paraburgosur të lejohet për kryerjen e betimit apo marrjen e detyrës publike. Gjithashtu, e drejta e kërkuesit për të bërë betimin me qëllim marrjen e mandatit nuk mund të konsiderohet si mbizotëruese në raport me përmbushjen e interesit kushtetues për zhvillimin e një procesi të rregullt e të drejtë ligjor për gjykimin e veprës penale për të cilën akuzohet kërkuesi. Edhe për pretendimet se në raste të ngjashme është dhënë leja nga institucioni përkatës, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se arsyetimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë përmbush standardet e arsyetimit të vendimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-769, datë 25.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

12. Në datën 23.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 10.12.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se i është cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

13.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat nuk kanë pranuar pretendimet e kërkuesit, për shkak se ligji nr. 81/2020 nuk ka parashikime se si realizohet e drejta e tij për t'u zgjedhur, duke iu mohuar e drejta për të pasur një zgjidhje efektive dhe përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

13.1.2. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi gjykata e apelit (trupi gjykues monokratik) nuk ka pasur kompetencën funksionale për shqyrtimin e ankimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili është shprehur për kompetencën lëndore dhe funksionale, ka përcaktuar se për ankimin ndaj aktit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kompetente është gjykata që gjykon themelin, pra çështjen në ngarkim të kërkuesit. Për sa kohë kjo e fundit gjykohet nga tre gjyqtarë, edhe ankimi ndaj aktit duhet të shqyrtohej po nga një trup me tre gjyqtarë.

13.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi një nga gjyqtarët e Kolegjit Penal në Gjykatën e Lartë, i cili ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit, është i njëjtë me atë që ka vendosur zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis gjykatave. Ky gjyqtar ka kryer interpretime të ndryshme në lidhje me përcaktimin e dispozitave procedurale penale që rregullojnë kompetencën funksionale.

13.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë kuptuar objektin e gjykimit, i cili nuk ka të bëjë me ushtrimin e detyrës, por me të drejtën për të kryer betimin. Edhe gjykata e apelit nuk ka arsyetuar cili ligj dhe dispozitë ligjore parashikon kufizimin e së drejtës së kërkuesit për t'u zgjedhur. Po kështu, kjo gjykatë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit se gjykata e shkallës së parë ka cenuar parimin e ndarjes së pushteteve duke dhënë orientime antikushtetuese, çka provon dhe politizimin e gjykatës. Tejkalimi i kompetencave të gjykatës së

shkallës së parë duhet të ishte konstatuar nga gjykata e apelit, duke pranuar se në rastin e kërkuarit ka pasur një gjykim të njëanshëm. Këto të meta nuk janë riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila ka përsëritur arsyetimin e gjykatës së apelit.

13.2. *E drejta për t'u zgjedhur dhe parimi i proporcionalitetit*, të garantuar nga nenet 45 dhe 17 të Kushtetutës, pasi shkresa nr. 1938/2023, për refuzimin e tij për të kryer procedurën e betimit, përbën kufizim pa ligj të së drejtës për t'u zgjedhur dhe ka cenuar thelbin e së drejtës. Ekzistenca e një mase sigurimi personal nuk nënkupton kufizimin e së drejtës për t'u zgjedhur, pasi Kushtetuta kërkon që ky kufizim të jetë i shprehur në ligj, pra jo i nënkuptuar, dhe, po ashtu, në vendimin gjyqësor me të cilin kërkuarit i është caktuar masa e sigurimit nuk rezulton një kufizim i tillë. Kufizimet e së drejtës për t'u zgjedhur të shtetasve që ndodhen nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg” nuk ekzistojnë në asnjë legjislacion dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në shkresën e saj nuk i është referuar ndonjë parashikimi ligjor, i cili parashikon kufizimin e së drejtës për t'u zgjedhur. Kërkuari nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 45, pika 3, i Kushtetutës, për kufizimin e së drejtës së tij për t'u zgjedhur. E drejta e tij nuk i është kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me ligj.

13.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i parashikuar nga nenet 18 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së, pasi ai nuk është trajtuar njësoj si shtetasit e tjerë që kanë qenë në të njëjtat kushte me të. Rasti i deputetit A.H. është sjellë në vëmendje të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i cili edhe pse ka qenë nën e masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, nuk është penguar të marrë mandatin e deputetit. Kjo e drejtë i është njohur atij shtetasi me vendimin nr. 4, datë 23.07.2001 të Gjykatës së Lartë. Edhe në rastin e ish-deputetit tjetër M.F., i cili ka qenë nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, nga parlamenti i është kërkuar leje Prokurorisë së Përgjithshme që ky shtetas të paraqitet në një seancë parlamentare. Nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga institucionet e burgjeve është dhënë leja dhe shtetasi M.F. është lejuar të marrë pjesë në dy seanca parlamentare. Në këtë kuptim, nga parlamenti, që është organi i cili ka miratuar ligjet për të drejtat e të burgosurve dhe nga Prokuroria e Përgjithshme është interpretuar se jepet leje për t'u paraqitur në seanca parlamentare edhe kur ligji nuk e parashikon një gjë të tillë. Vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk i ka interpretuar si shteruese rastet e parashikuara nga

neni 73 i ligjit nr. 81/2020, për shoqërimin e të burgosurve/paraburgosurve jashtë institucionit të paraburgimit. Gjykatat kanë keqinterpretuar ligjin dhe Kushtetutën, duke miratuar leje për persona të tjerë, ndonëse këto raste nuk parashikohen shprehimisht në ligj.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuarra në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur. Këto kriterë paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, prandaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi, si subjekt i kushtëzuar, duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin në shqyrtim objekt i ankimit kushtetues individual janë akti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që i ka refuzuar kërkuësit dhënien e lejes së veçantë për të bërë betimin si kryetar i zgjedhur i Bashkisë Himarë, ndërkohë që ai gjendej nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, si dhe vendimet gjyqësore në lidhje me të. Kërkuësi ka pretenduar se

ankimi i tij nuk ka të bëjë me ushtrimin e detyrës së kryetarit të bashkisë, por me të drejtën për të kryer betimin dhe se në këtë kuptim akti administrativ e vendimet gjyqësore kanë cenuar thelbin e së drejtës për t'u zgjedhur. Në këtë këndvështrim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor objekt i ankimit kushtetues individual, si dhe ka identifikuar të drejtën kushtetuese të pretenduar si të cenuar dhe në këtë kuptim interesin e tij vetjak për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor të kundërshtuar në shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 25.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 23.09.2024. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë i është komunikuar përfaqësuesit të tij në rrugë elektronike në datën 14.06.2024, ndaj është kjo datë momenti nga i cili fillon afati ligjor 4-mujor i përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Prandaj, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

20. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, parimit të gjykatës së caktuar me ligj, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga nenet 42, pika 2 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, si dhe së drejtës për t'u zgjedhur, parimit të proporcionalitetit dhe parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuar nga nenet 45, 17 dhe 18 të Kushtetutës.



21. Në analizë të pretendimeve të kërkuarit dhe të kontekstit të rrethanave të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se thelbi i argumenteve të parashtruara prej tij lidhet me ushtrimin e së drejtës për t'u betuar, e cila është pjesë përbërëse e së drejtës për t'u zgjedhur. Në këndvështrim të garantimit të kësaj të drejte kushtetuese, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kufizimi që është vendosur ndaj kërkuarit në ushtrimin e së drejtës për t'u betuar është i ndërlidhur me ekzistencën e një vepre penale për të cilën ndaj tij ishte vendosur masa e sigurimit personal dhe për të cilën, në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, ai po gjykohej ende nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*Gjykata e Lartë*). Kjo do të thotë se, në thelb, ky kufizim është rrjedhojë e zbatimit të një mase sigurimi personal të vendosur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, vendimet e të cilave, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin 4 të vendimit*), kanë qenë objekt të kontrollit kushtetues, që ka rrëzuar kërkesën e kërkuarit. Thënë ndryshe, kufizimi i së drejtës për t'u zgjedhur nuk është rezultat i shkresës së drejtorit të përgjithshëm të burgjeve që i ka refuzuar kërkuarit dhënien e lejes së veçantë për të bërë betimin si kryetar i zgjedhur i Bashkisë Himarë, ndërkohë që ai gjendej nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg” apo i vendimeve gjyqësore në lidhje me të. Në këtë kuptim, në kushtet kur Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuari nuk ka arritur të provojë se cenimi i së drejtës për t'u zgjedhur ka ardhur pikërisht nga akti (shkresa) nr. 1938/2023, pretendimet e tij në lidhje me këtë akt, si dhe me vendimet gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual nuk mund të merren në shqyrtim.

22. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri, me objekt “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 467 datë 11.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr. 22, datë 29.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr. 00-2024-769, datë 25.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së të drejtave kushtetuese të kërkuesit Dhionisios Alfred Beleri*”, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare për arsyet e mëposhtme.

2. Në ndryshim nga shumica, ne vlerësojmë se ndërsa kufizimi i lirisë së kërkuesit ka ardhur për shkak të masës së sigurimit personal të heqjes së lirisë “Arresti në burg”, cenimi i së drejtës për t’u zgjedhur rezulton të ketë ardhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga akti i kundërshtuar, shkresa nr. 1938/2023 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që i ka refuzuar kërkuesit dhënien e lejes së veçantë për të bërë betimin si kryetar i zgjedhur i Bashkisë Himarë, ndërkohë që ai gjendej nën këtë masë të sigurimit personal.

3. Edhe në vlerësimin e legjitimitimit *ratione personae*, shumica e ka lidhur interesin e kërkuesit pikërisht në aspektin e këtij elementi përbërës (e drejta për t’u betuar) të së drejtës për t’u zgjedhur dhe të lidhur me aktin individual ndalues/kufizues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ndërkohë që në vlerësimin e kriterit të legjitimitimit *ratione materiae* shumica nuk i referohet më këtij akti, por e lidh çështjen e kërkuesit me ekzistencën e veprës penale për të cilën është vendosur masa e sigurimit personal. Në rastin konkret masa e sigurimit personal me natyrë kufizuese është vendosur në kuadër të procedimit penal ndaj kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e një veprë penale, por nuk përbën një masë kufizuese në ekzekutim të një vendimi dënimi për kërkuesin. Kjo nënkupton se në këndvështrim të parimit të prezumimit të pafajësisë kërkuesi ka të drejtë të kërkojë ushtrimin e të drejtave të tij të tjera kushtetuese, përfshirë atë për t’u zgjedhur, si një e drejtë kushtetuese që atij jo vetëm i buron nga mandati i fituar nga zgjedhësit, por edhe që nuk është ndaluar ende ta ushtrojë për sa kohë ndaj tij nuk ka një vendim penal themeli apo ndonjë masë tjetër ndaluese në këtë drejtim.

4. Në këtë këndvështrim, kufizimi i lirisë personale me një vendim të ndërmjetëm të dhënë në kuadër të një procedimi penal në zhvillim nuk mund të legjitimojë dhe të përbëjë shkak

për justifikimin e kufizimit edhe të të drejtave të tjera kushtetuese. Për rrjedhojë, për sa kohë që realizimi i procedurës së betimit, si kusht procedural për ushtrimin e së drejtës për t'u zgjedhur, është penguar nga akti “shkresë e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve”, i kundërshtuar gjyqësisht, çmojmë se provohet ardhja e pasojës nga ky akt.

5. Në përfundim, për sa kohë pretendimet e kërkuarit nuk janë haptazi të pabazuara, lindte nevoja për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare për vlerësimin në themel nëse ky kufizim plotëson kriteret kushtetuese që lejojnë ndërhyrjen në të drejtat individuale.

**Kryetare: Holta Zaçaj**

**Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahim**